

PËRMBLEDHJE



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

SUBJEKTI I MONITORUAR: ENERJETA SHEHAJ, GJYQTARE, GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË TIRANË

Raportim paraprak i seancës dëgjimore të datës 18/10/2022, realizuar pranë KPK

- ✓ **Kriteri i pasurisë: U kërkuan shpjegime shtesë për disa prej pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të rivlerësuar**
- ✓ **Vlerësimi i aftësive profesionale: Raport pozitiv nga KLGJ, por 4 denoncime të publikut, të sjella në vëmendje nga ONM, ngjallën diskutime dhe debate**
- ✓ **Vlerësimi i kontrollit të figurës konfirmoi përshtatshmërinë e subjektit në kryerjen e detyrës**



NJOFTIM I PËRMBLEDHUR

Vëzhguesi i autorizuar i Komitetit Shqiptar të Helsinkit monitoron seancën dëgjimore të realizuar pranë KPK, mbi rivlerësimin e kriterëve ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë, Znj. Enerjeta Shehaj

Me datë 18.10.2022 ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Enerjeta Shehaj, Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë për shkak të funksionit si gjyqtar, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

Trupa gjyquese e përbërë nga Firdes Shuli (Kryetare), Xhensila Pine (Relatore) dhe Olsi Komici (Anëtar), u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë kësaj séance, KPK bëri me dije se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit ka përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu KPK relatoi se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë seancës dëgjimore, pas relatimit të çështjes, fjalën e mori subjekti i rivlerësimit, duke papësuar kundrejt konstatimeve të hetimit administrative, si dhe duke realizuar mbrojtjen mbi barrën e provës që i ishte kaluar nga KPK.

Referuar nenit 52 të Ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ishte kaluar barra e provës për disa elementë të kriterëve objekt rivlerësimi, si:

- Sa i përket **kriterit të pasurisë**, u kërkua relativitet dhe analizë më e detajuar nga ana e subjektit mbi pasurinë e paluajtshme apartament ndodhur në Tiranë, ku sipas KPK subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur në rolin e huadhënësit nuk kishin pasur burime financiare të mjaftueshme; për blerjen e një automjeti në vitin 2016; si dhe për përdorimin e një automjeti në vitin 2015
- Referuar **vlerësimit të aftësive profesionale**, KLGJ rezultoi se ka dorëzuar raport pozitiv, por debate në seancë u konstatuan në rastet e shqyrtimit të 4 denoncimeve të adresuara nga publiku. Këto denoncime të sjella në vëmendje nga ONM, mbi dosje gjyqësore të

gjykuara nga subjekti, u bënë pjesë e një debati mes përfaqësuesit të ONM dhe vetë subjektit të rivlerësimit.

- **Vlerësimi i kontrollit të figurës** konfirmoi përshtatshmërinë e subjektit në kryerjen e detyrës. Subjekti i rivlerësimit në fjalën përmbyllëse, falenderoi KPK për një hetim të drejtë dhe kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për shpalljen e vendimit u caktua me datë 20.10.2022 ora 09:30.